



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh II.nr.288/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija-Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit PANDORA A/S me seli në Havneholmen 17-19DK-1561, Kopenhagë-Danimarkë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Vokshi&Lata me seli në Prishtinë me avokatë A.A.A., kundër të paditurës Jewellery&Oruçi N.P.T-B.O. B.I, me NUI 811547481, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve Jupolli & Associates me seli të zyrës në Prishtinë Avokat A.J., për shkak të shkeljës së markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr.1688/22, të datës 31.10.2023, me datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si të pabazuar ankesa e paditurës Jewellery&Oruçi N.P.T-B.O. B.I me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr.1688/22, të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e Dhomës së shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka vendosur si në vijim;

“I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit PANDORA A/S me seli në Havneholmen 17-19 DK-1561,Kopenhagë-Danimarkë.

II.VËRTETOHET se i padituri Jewellery&Oruçi N.P.T-B.O. B.I, me NUI 811547481 me seli në Prishtinë ka shkelur markën tregtare PANDORA A/S me numër të regjistrimit 13341,15741 dhe 15738.

III. I NDALOHET të paditurës “Jewellery&Oruçi N.P.T-B.O. B.I, që në të ardhmen të shes mallra që shkelin markën tregtare të paditësit PANDORA A/S.

IV.Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.”

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ta aprovoje në tërësi si të bazuar ankesën e paditurës, të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja i kthehet në shkallë të parë për rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqit e paditësi me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës si të pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale e ka shqyrtuar ankesën e paditurës Jewellery&Oruçi N.P.T-B.O. B.I dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të paditurës, shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës secilën veç e veç e edhe lidhshmërinë e tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti Ankesa e paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi PANDORA A/S me seli në Havneholmen 17-19 DK-1561,Kopenhagë-Danimarkë, ka paraqitu padi me datën 15.12.2021 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet shkelja e markës tregtare si dhe ti ndalohet të paditurës që në të ardhëmen të shes mallra që shkelin markën tregtare të paditësit.

Gjykata e Dhomës së shkallës së parë pas administrimit të provave dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqës ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, me arsyetim se nga regjistrimi i markës tregtare me numër 013341 e datës 19.09.2014, me numër 015738 e datës 30.07.2015 me numër 015741

e datës 30.07.2015, vërtetohet se paditësi është bartësi i markës tregtare është Pandora, po ashtu ka theksuar se shenja që është përdorur në produktet e të paditurit janë indentike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit. Ka theksuar se nga Dogana e Kosovës konfirmohet se mallrat të cilat janë importuar nga e paditura nuk janë të regjistruar si marka tregtare, prandaj këto mallra të cilën mbajnë shenjën e markës së mirënjohur Pandora duhet të shkatërrohen sepse përbëjnë shkelje të markës tregtare. Kështu gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.04/L-026 Për Markën Tregtare i aplikushëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njejtat përbëjnë të drejta absolute. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës nuk rezulton si jokontestuese fakti se i padituri ka importuar mallrat kontestuese pa autorizimin e paditësit si bartës i të drejtave nga marka tregtare e regjistruara “PANDORA”, atëher fakti se mallrat janë në origjinal ose jo, nuk përbën fakt relevant për vlerësimin e shkeljes së markës tregtare, andaj bazuar në dispozitat e sipërcituara vetëm fakti i importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, përbën shkelje të markës tregtare. Gjykata e shkallës së parë ka cek se edhe sipas nenit 12 të të njejtit ligji nënkuptohet se shterja e së drejtës sipas shitjes së parë bëhet vetëm në rastet kur bartësi i të drejtës së markës tregtare e shet vet atë produkt apo përmes të autorizuarit të tij, në territorin e Republikës së Kosovës, por kjo e drejtë nuk konsumohet nëse produkti është shitur jashtë Republikës së Kosovës, andaj e paditura me importimin e mallrave kontestuese dhe vënien e tyre në treg, pa autorizimin e bartësit të markës tregtare të regjistruar, e ka shkelur markën tregtare të paditësit. Krejt në fund ka cek se vendimi për shkarkimin e prodekteve dhe atë 4 copë (bizhuteri argjendi-rruza), 16 copë (bizhuteri argjendi-byzylyk), 1 copë (bizhuteri argjendi-hallkë dore), me shpenzimet e të paditurës, gjykata e morri konform dispozitave të nenit 28 të Ligjit Nr.05/L-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-026 për Markën Tregtare dhe nenin 99 të të njejtën ligj.

Dhoma e Shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Dhoma e Shkallës së Dytë mbështet në tërësi konstatimet dhe spjegimet lidhur me faktet dhe rrethanat vendimtare të cilat kanë prurë që të miret një aktgjykim aprovues, e që në mënyrë të thukët i ka dhënë Gjykata e Dhomës së Shkallës së Parë. Dhoma e Shkallës së Dytë po ashtu konstaton se nuk qendrojnë pretendimet ankimore sa i përketë vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike sepse gjykata ka administruar gjitha provat e propozuar, dhe i ka vlerësuar se cilën veq e veq e edhe varshmërinë e tyre dhe ka gjetë se çështja faktike është vërtetuar drejtë dhe në bazë të kësaj çështje faktike drejtë janë aplikuar dispozitat ligjore, të cekura më hodhësisht në aktgjykimin e kundërshtuar.

Kështu që Gjykata e Shkallës së Parë me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale ka marrë aktgjykimin me të cilën e ka aprovuar padin dhe kërkesëpadin e paditësit, e cila ka kërkuar që të vërtetohet se e paditura ka shkelur markën tregtare të paditësit. Edhe kjo Gjykatë e Dhomës së Shkallës së Dytë e mbështet konstatimet dhe vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se në këtë çështje civile-juridike nuk është kontestuese se nga certifikata e biznesit B.O. B.I e lëshuar nga ARBK e datës 12.10.2021 vërtetohet se emri tregtar i biznesit individual është N.P.T Jewellëry & Oruçi me seli në Prishtinë. Nuk është kontestuese se marka tregtare Pandora A/S është e regjistruar me nr,013341 e datës 19.09.2014, me numër 015738 e datës 015741 e datës 30.07.2015 dhe vërtetohet se kjo markë tregtare Pandora në vazhdimësi është e regjistruar si markë tregtare dhe gëzon mbrotje juridike sipas Ligjit për Markën Tregtare në Republikën e Kosovës. Nuk është kontestuese fakti se shenja që është përdorur në produktet e të paditurës janë identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit dhe të cilat shkaktoj konfuzion në publik edhe secili konsumator do të krijoj bindje se bëhet fjalë për produktet e paditësit . Andaj, në bazë të gjithë këtyre provave të administruara të vërteta dhe të pakontestushëme gjykata e shkallës së parë ka vendos që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit. Një konstatim të tillë i gjykatës së shkallës së parë është e pranushme edhe për Dhomën e Shkallës së Dytë. Andaj me Ligjin Nr.04/L-0126 Për Markën Tregtare e aplikushme në rastin konkret gjegjësisht neni 8 parashihet se të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjë identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare. Në këtë rast bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare, sipas këtij ligji bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta të ndalojë përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion të neneve 8-13 të LMT,

e cila e përdorë markën e rregjistruar në tregun e Kosovës sipas nenin 14 të LMT si dhe të disponojë me markën tregtare të tij. Mbajtësi i një marke tregtare sipas nenin 8 të LMT, ka të drejtë të ndalojë; vendosjen e markës së mbrojtur, në mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruatjen e saj për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare dhe përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama. Duke pas parasysh dispozitat e Ligjit Për Markën Tregtare më konkretisht nenin 8 parashihet se shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëren prej të drejtave të pronarit të markës tregtare, kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar, andaj përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj përbën shkelje të markës tregtare.

Me ankesë pretendohet se biznesi i të paditurit që nga viti 2006 nuk funksionon dhe se i njëjtit nuk ka pasur mundësi që ta cenoj markën tregtare të paditësit, dhoma e shkallës së dytë të kësaj gjykate i refuzoi si të pa bazuar për faktin se e paditura ka qenë duke ushtruar veprimtarin e saj e cila vërtetohet nga certifikata për rregjistrimin e biznesit e datës 12.03.2013 B.O. B.I-N.P.T “Jewellery & Oruçi”, ndërsa rasti lidhur me shkeljen e markës tregtare është bërë me datën 22.09.2021 dhe atë sipas shkresës së Doganës së Kosovës, kurse biznesi i të paditurës është pasive që nga data 09.06.2022 që do të thot shumë kohë pas rastit konkret e edhe pas paraqitjes së padisë nga paditësi. Po ashtu nuk qendron as pretendimi tjetër ankimuar lidhur me at se para Gjykatës Komerciale të Kosovës është duke u zhvilluar procedura gjyqësore KE.nr.2641/22 për të njëjtin rast dhe me të njetat produkte, sepse kjo procedurë me shenjën e lartë cekur ka përfunduar me aktvendimin KE.nr.2641/22 të datës 17.11.2023 me të cilën është konstatuar e tërhequr padia e paditësit, si dhe në këtë procedurë shifet se janë subjekte të ndara dhe të tjera njëra prej tjetrës me NUI të ndryshme me adresa të ndryshme, dhe më pronar të ndryshëm.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e Shkallës ë Dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh II.nr.288/24 dt.14.03.2023

Krytarja e kolegjit

Franciska Zhitija-Ymeri